| **Buletini Nr. 24 / 2026, 24-01-2026** | **Parashikimi** nga 24-01-2026, ora 12:00 deri 25-01-2026, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI METEO

----------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e shtunë, dt. 24) në qarkun Shkodër priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare, ndërsa në qarqet e tjera priten reshje të dobëta. Nesër (e diel, dt. 25) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarkun Shkodër, ndërsa të dobëta deri lokalisht mesatare në qarqet Kukës dhe Vlorë të shoqëruara me shtrëngata. Në të gjitha qarqet e tjera priten reshje të dobëta (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në Veri në lartësitë mbi 900 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si rënie gurësh e inertesh dhe vërshime të ujit në zonat urbane të lokalizuara, në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarkun Shkodër.

### TEMPERATURA

Nesër (e diel, dt. 25) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 11 / 19 °C

në vendet e ulëta: 9 / 19 °C

në vendet malore: 2 / 12 °C

### ERA

Sot pasdite (e shtunë, dt. 24) dhe nesër (e diel, dt. 25) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë kryesisht në bregdet dhe në vendet malore.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LART** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret***<br>***Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe***<br>***Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe***<br>***Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare |  | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare |  | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë)<br>Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 24–25.***

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
| | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
| | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
| | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
| | Rrëshqitje toke |